

## Angazhimi politik i serbëve të Kosovës: A ka bojkoti alternativë?

Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) ka organizuar një tryezë të rrumbullakët për një numër përfaqësuesish të partive politike të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Takimi është mbajtur me 6 dhjetor 2016 në Prishtinë. Qëllimi i diskutimit ka qenë analizimi i bojkotit të Listës Serbe në parlamentin dhe qeverinë e Kosovës, ndikimin e bojkotit, dhe kërkimin e zgjidhjeve alternative më të mira. Përfaqësuesit serbë janë ankuar se qeveria e Kosovës nuk u ka dhënë atyre hapësirën e nevojshme për t'i realizuar qëllimet e tyre, sidomos në rastin e krijimit të Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumice serbe, dhe së këndejmi, bojkoti ka qenë opioni i tyre i fundit. Folësit tjerë kanë thënë se Lista Serbe është joefektive kryesisht për shkak se funksionon si mjet politik i Beogradit, e jo si një forcë autentike politike e serbëve të Kosovës.

Takimi është përkrahur dhe organizuar në bashkëpunim me Departamentin Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.

Njëri nga folësit ka theksuar se besimi i ndërsjellë është i domosdoshëm për përfshirjen e qëndrueshme të serbëve të Kosovës në institucione, si dhe për bashkëpunimin e tyre me kolegët shqiptarë, dhe ka shtuar se ky besim i ndërsjellë është duke u dobësuar dita ditës. Përfaqësuesit serbë duhet të jenë në pozita vendimmarrëse dhe duhet të punojnë për të implementuar marrëveshjen e koalicionit me LDK-në dhe PDK-në, marrëveshje kjo e cila përfshin Asociacionin/Komunitetin. Ky folës ka thënë se përfaqësuesve serbë nuk u jepet hapësirë e mjaftueshme për implementimin e objektivave të tyre politike, dhe se ligji për Trepçën ka bërë që i gjithë procesi të devijojë. Ky folës poashtu ka përmendur mungesën e lirisë së lëvizjes për serbët e Kosovës, duke përmendur rastin e Mushtishtit, ku një numër i serbëve të Kosovës nuk janë lejuar t'i vizitojnë shtëpitë e tyre. Një tjetër folës ka thënë se liria e lëvizjes është çështje problematike në disa pjesë të Kosovës. “Serbët nuk mund të shkojnë në Mushtisht, kurse shqiptarët nuk mund të shkojnë në veri”.

Folësit shqiptarë janë pajtuar së besimi i ndërsjellë dhe marrëdhëniet mes serbëve dhe shqiptarëve janë ende të ndjeshme. “Marrëdhëniet mund të duken të mira në sipërfaqe, por me ta gërvishur pak sipërfaqen, shohim se nuk ka ndonjë themel të fortë”. Njëri nga folësit ka thënë se serbët do të duhej të ishin pjesëmarrës aktiv në proceset politike dhe t'i adresojnë problemet reale. Marrëdhëniet ndëretnike janë të rëndësishme jo vetëm për integritet, por edhe për zhvillim ekonomik të Kosovës. Ai ka propozuar që politikanët e Kosovës mos ta bazojnë angazhimin e tyre politik në çështjet etnike, por në ato

ekonomike. “Çështjet etnike thjesht manipulohen sepse, fatkeqësisht, ato ende sjellin vota, edhe pse gjithnjë e më pak”. “Secili faktor i përfshirë ka përgjegjësi të barabartë për gjendjen aktuale dhe për zgjidhjen e saj”, ka theksuar njëri nga folësit.

Një tjetër folës ka thënë se serbët e Kosovës dhe Lista Serbe duhet të shndërrohen në urë të bashkëpunimit, e jo në përçarës të marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë. Ai ka thënë se lufta përmes bojkotit nuk është e suksesshme, dhe se ajo e dëmton vetëm Listën Serbe, e cila në Kosovë shihet si dorë e zgjatur e Serbisë. Ky folës poashtu ka thënë se qeveria e Kosovës mund të fajësohet për shumëçka, por se bojkoti i serbëve nuk është përgjigja e duhur në këtë rast. Problemi është se serbët e Kosovës nuk e kuptojnë fuqinë e tyre dhe nuk dijnë ta përdorin atë. “Ata kanë shumë fuqi politike në duart e tyre; ata mund t’i bllokojnë ligjet në parlament”. Një folës ka thënë se është në interesin e Listës Serbe ta ndërtojë integritetin e saj dhe të bëhet një forcë politike serioze, e jo të mbetet mjet në duart e dikujt tjetër.

Një tjetër folës ka thënë se përfaqësuesit e serbëve të Kosovës duan “benefite, pa përgjegjësi”. Komunitat e veriut pranojnë fonde nga buxheti i Kosovës, por refuzojnë t’i aplikojnë ligjet e Kosovës. Kjo është arsyeja pse fondi për veriun ende nuk është shfrytëzuar. Përfaqësuesit serbë kanë refuzuar ta pranojnë prokurimin sipas ligjeve të Kosovës, dhe për shkak të kësaj, 15 milionë euro mbesin thjesht të pashfrytëzuara. Ata poashtu i kanë refuzuar 13 milionë euro në investime kapitale nga qeveria e Kosovës. Përkundër kësaj, Prishtina ka marrë një qasje praktike dhe i ka shpërndarë shumicën e këtyre fondeve. Një nga folësit ka konkluduar se Prishtina nuk është kundër konsultimeve dhe bashkëpunimit mes serbëve të Kosovës dhe Beogradit, por ato duhet të zhvillohen më tej dhe t’i përfaqësojnë interesat e tyre dhe ato të Kosovës.

Njëri nga folësit ka thënë se është bërë pothuajse trend të akuzohet Beogradi për gjithçka, dhe gjatë gjithë kohës. Por sukcesi në veri ka ardhur falë Beogradit. Ai ka shpjeguar se njerëzit në veri janë të zhgënjyer dhe të çorientuar nga shumë deklaratatë të zyrtarëve të Serbisë dhe Kosovës, si dhe nga zhvillimet në terren. “Zyrtarët e Kosovës thonë se kryeqyteti juaj është Prishtina, kurse zyrtarët serbë thonë se ju jeni pjesë e Serbisë, por duhet të integrohemi në Kosovë”. Në mënyrë që të ndodhë integrimi i vërtetë, serbët e Kosovës duhet të ndjehen si pjesë e Kosovës dhe të mirëseardhur në Kosovë. Ekzistojnë shumë gjëra të cilat qeveria e Kosovës mund t’i bëjë në një afat të shkurtër: ta respektojë ligjin për gjuhët, ta përmirësojë cilësinë e përkthimit të dokumenteve zyrtare, dhe ta përmirësojë lirinë e lëvizjes. Ajo poashtu do të mund të ofronte më shumë informata në lidhje me dialogun e Brukselit; njerëzit në veri kanë shumë pak informata rreth pasojave që kanë këto marrëveshje për veriun.

## **Ide për tu konsideruar**

Më poshtë janë një numër i qëndrimeve, pyetjeve, dhe ideve të përmendura gjatë takimit, të cilat janë konsideruar si çështje potenciale për tu diskutuar në takimet e ardhshme të CIG.

- Si të shndërrohet komuniteti serb në urë, e jo në përçarës mes Prishtinës dhe Beogradit?
- Serbët e Kosovës duhet ta definojnë dhe ta përdorin peshën e tyre politike. Ata mund të jenë më efikas dhe më të fuqishëm sa tani.
- Çfarë ndodhë pas bojkotit? Bojkoti është mjet legjitim politik, por nevojitet një analizë për të parë nëse ai sjellë rezultatet e dëshiruara, dhe nëse ekzistojnë alternativa tjera më të mira për adresimin e problemeve ekzistuese. Partitë opozitare të Kosovës poashtu e kanë bojkotuar parlamentin për një periudhë kohore, por sipas mendimit të shumë folësve, janë kthyer përsëri pasi që kanë kuptuar se pjesëmarrja e tyre është më efektive se bojkoti. Disa nga folësit kanë thënë se Lista Serbe do të mund t'i bojkotonte disa seanca të caktuara, por jo gjithë punën parlamentare.
- Liria e lëvizjes nuk është e mirë as në veri, e as në jug (shembujt e përmendur kanë qenë Mushtisht, Gjakova, dhe vizita e kryeministrit të Kosovës në veri). Disa nga folësit kanë thënë se ata kanë qenë të zhgënjyer nga mungesa e deklaratave më të fuqishme nga shqiptarët me ç'rast do ta dënonin ndalesën që iu është bërë serbëve për t'i vizituar shtëpitë e tyre. Gjithashtu, shumë prej pjesëmarrësve kanë thënë se deklaratat e zyrtarëve serbë, e sidomos ato të institucioneve lokale në veri rreth vizitës së kryeministrit në veri kanë qenë të pavenda.
- A është çdo gjë që ka të bëjë me përfshirjen e Beogradit e keqe? A do të mund të shënohet progres në veri pa Beogradin? Disa nga folësit kanë thënë se procesi i integritetit të veriut ka ndodhur pikësepari, falë Beogradit. Disa prej pjesëmarrësve kanë pyetur se nëse shqiptarët e Kosovës thonë se përfshirja e Beogradit nuk është e mirë, pse atëherë Prishtina flet kryesisht me Beogradin, duke anashkaluar kështu serbët e Kosovës? Vetë Prishtina është duke e lehtësuar përfshirjen e Beogradit në punët e Kosovës.
- Fondi për zhvillim për veriun tashmë ka mbledhur më shumë se 15 milion euro, por nuk është përdorur ende për arsye politike. Duhet gjetur një mënyrë për t'i investuar këto mjete në veri.
- Asociacioni/Komuniteti është pjesa kryesore e marrëveshjes së koalicionit, dhe si i tillë, ai duhet të implementohet nga qeveria e tanishme. Do të ishte e vështirë për serbët e Kosovës të marrin pjesë në zgjedhje të reja pa Asociacionin/Komunitetin.
- Serbët në veri janë ende të zhgënjyer dhe të çorientuar. Të gjithë flasin dhe vendosin për ta, por askush nuk i pyet për asgjë.
- Më shumë kohë duhet të shpenzohet për të përfshirë në proces të "pakonvertuarit", dhe duhet të ketë më shumë konsultime, edhe nëse kjo shkakton ngadalësimin e procesit vendimmarrës, siç është modeli zviceran, i cili mund të duket joefikas, por është i qëndrueshëm.
- Normalizimi mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës, dhe mes Beogradit dhe Prishtinës janë dy procese të ndryshme. Një dialog i brendshëm është i domosdoshëm për ta adresuar normalizimin mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës.
- Toni i komunikimit mes serbëve dhe shqiptarëve duhet të jetë më profesional.

- Është arritur një progres mjaft i madh, por procesi është ende larg nga caku i dëshiruar, i cili përfshin normalizimin e plotë. Shqiptarët dhe serbët nuk duhet t'i shpenzojnë edhe 17 vite tjera që ta arrijnë këtë cak.

Jemi munduar të jemi sa më të saktë dhe të balancuar në përmbledhjen e diskutimeve, dhe së këndejmi, kërkojmë mirëkuptimin e pjesëmarrësve qëndrimet e të cilëve mund të mos jenë përfshirë plotësisht në këtë raport të shkurtër. Diskutimi është mbajtur nën rregullat e Chatham House.

## Pjesëmarrësit

**Besim Beqaj**, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës  
**Illir Deda**, Anëtar i Parlamentit të Kosovës  
**Aida Derguti**, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje  
**Sadri Ferati**, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës  
**Dalibor Jevtic**, Ministër për Komunitete dhe Kthim i Kosovës  
**Donika Kadaj-Bujupi**, Anëtare e Parlamentit të Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje  
**Ljubisa Mijacic**, Analist, Zubin Potok  
**Miodrag Milicevic**, Drejtor ekzekutiv, OJQ Aktiv, Mitrovicë Veri  
**Nenad Radosavljevic**, Drejtor, RTV Mir, Leposaviq  
**Nenad Rasic**, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lista Serbe  
**Elmi Recica**, Anëtar i Parlamentit të Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës  
**Ylli Valla**, Drejtor, Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave,  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës  
**Shpetim Gashi**, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Alex Roinishvili Grigorev**, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Arber Kuci**, Përfaqësues në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Jean-Hubert Lebet**, Ambasador i Zvicrës në Kosovë  
**Saskia Salzmann**, Këshilltare Rajonale e Sigurisë Njerëzore, Departamenti Federal i  
Punëve të Jashtme i Zvicrës